

Avokati i Popullit mbikëqyr, promovon dhe mbron të drejtat dhe liritë themelore të personave fizik dhe juridik nga veprimet ose mosveprimet e paligjshme dhe të parregullta të autoriteteve publike, institucioneve dhe personave apo autoriteteve tjera të cilët ushtrojnë autorizime publike në Republikën e Kosovës.

Avokati i Popullit heton ankesat e pranuar nga qytetarët lidhur me pohimet për shkeljen e të drejtave të njeriut dhe lirive themelore të parapara me kushtetutë, ligje dhe akte tjera, si dhe me standarde ndërkombëtare.

Zyra në Prishtinë

Rr. "Migjeni", nr.21, 10000 Prishtinë
Tel: +383 (0) 38 223 782

Puna me palë :

Çdo ditë pune, prej orës 08:00 - 16:00

Për ankesa telefononi në numrin:

080015555 pa pagesë

Email: info.oik@oik-rks.org

<https://www.oik-rks.org/>

ZYRAT RAJONALE TË AVOKATIT TË POPULLIT

Zyra në Prizren

Adresa: Rr. "Remzi Ademi", p.n.
Ndërtesa e Administratës Pensionale Regjionale në
Prizren, kati i III.

Tel: +383 (0)29 222 138

Zyra në Pejë

Adresa: Rr "Mbretëresha Teutë"
Nr.59, Kati III, Nr. 3, Ndërtesa e Komunës

Tel: +383 (0)39 432 931

Zyra në Gjiçan

Adresa: Rr "Bulevardi i Pavarësisë"
(ish ndërtesa e gjykatës), p.n.

Tel: +383 (0)280 320 843

Zyra në Ferizaj

Adresa:

Ndërtesa e Komunës (kati përdhësë)

Tel: +383 (0)290 326 032

Zyra në Gjakovë

Adresa: Rr. "Ismail Qemali"
(ish ndërtesa e Kadastrës)

Tel +383 (0)390 327 698

Zyra në Mitrovicë

Adresa: Rr. "Afrim Zhitia", p.n.
Ndërtesa e Administratës Pensionale të Kosovës, Kati-III,
Zyra Nr. 11 dhe 12

Tel: +383 (0)28 530 138

Nën-zyra, Mitrovicë

Adresa: Rr. "Sami Frashëri" p.n. Lagjja e Boshnjakëve,
Ndërtesa e ZAK në veri të Mitrovicës,
tel: 00381649560050 // + 383 (0) 45 455 319

Zyra në Graçanicë

Adresa: Rr. "Car Lazari", p.n.

Mobil: +383 (0) 44 367 719

Mobil: +383 (0) 44 322 979



Institucioni i Avokatit të Popullit në Republikën e Kosovës
Institucija Ombudsmana Republike Kosovo
Ombudsperson Institution of Republic of Kosovo

INSTITUCIONI I AVOKATIT TË POPULLIT

MISIONI, KOMPETENCAT DHE PËRGJEGJËSITË E INSTITUCIONIT TË AVOKATIT TË POPULLIT

Kompetencat e Avokatit të Popullit

Avokati i Popullit heton ankesat e pranuar nga çdo person fizik apo juridik;

Mund të hetojë raste edhe me vet-iniciativë (*ex-officio*);

Mund të iniciojë çështje në Gjykatën Kushtetuese, në pajtim me Kushtetutën dhe ligjin;

Mund t'u ofrojë shërbime të mira të gjithë banorëve si dhe personave të tjerë që ndodhen jashtë territorit të Republikës së Kosovës;

Ushtron kompetencat e veta edhe me anë të ndërmjetësimit dhe pajtimit;

Ofron edhe këshilla dhe rekomandime për çdo person fizik dhe juridik lidhur me pajtueshmërinë e ligjeve dhe akteve nënligjore me standardet e pranuar ndërkombëtare për të drejtat e njeriut;

Avokati i Popullit mund të paraqitet në cilësinë e mikut të gjykatës (*amicus curiae*) në proceset gjyqësore që kanë të bëjnë me të drejtat e njeriut, çështjet e barazisë dhe mbrojtjes nga diskriminimi;

Avokati i Popullit vepron edhe si mekanizëm ankese kundër diskriminimit, për barazi gjinore dhe për qasje në dokumente publike;

Avokati i Popullit vepron si Mekanizëm Kombëtar për Parandalim të torturës dhe trajtimeve e ndëshkimeve të tjera mizore, injerëzore dhe poshtëruese.

Përgjegjësia e Avokatit të Popullit për promovimin dhe edukimin mbi të drejtat e njeriut

Avokati i Popullit, ka për mandat promovimin dhe edukimin mbi të drejtat e njeriut dhe liritë themelore, përmes ngritjes së vetëdijesimit, posaçërisht përmes informimit dhe edukimit edhe me anë të mediave.

Çfarë veprimesh nuk mund të ndërmerr Avokati i Popullit?

Nuk mund të zëvendësojë gjykatat, të hetojë krime, të ndryshojë vendimet e gjykatave apo të ndërhyjë në punën e tyre, me përjashtim të zvarritjeve të paarsyeshme të procedurave;

Nuk mund të shqyrtojë ankesat kundër personave privat (përveç atyre që kanë të bëjnë me pohimet për diskriminim);

Nuk mund të përfaqësojë palët në gjykatë apo të ofrojë ndihmë juridike në përpilimin e ankesave apo shkresave të tjera;

Nuk mund të hetojë ankesat kundër autoriteteve të huaja;

Nuk mund të hetojë ankesat në rastet kur palët nuk i kanë shfrytëzuar mjetet efektive juridike

SI MUND TË PARASHTROHET ANKESA NË INSTITUCIONIN E AVOKATIT TË POPULLIT?

- Ankesat mund të parashtrihen në Zyrën Qendrore dhe në Zyrat Rajonale;
- Duke u paraqitur personalisht në njërin nga zyrat e IAP-së;
- Duke e plotësuar formularin e ankesës;
- Nëpërmjet linjës urgjente të telefonit të IAP-së (pa pagesë);
- Nëpërmjet postës dhe postës elektronike (me e-mail)

NË ÇFARË GJUHE MUND TË PARASHTROHET ANKESA?

Gjuhët zyrtare të punës në Institucionin e Avokatit të Popullit janë:

- Gjuha shqipe
- Gjuha serbe
- Ankuesi mund të parashtrijë ankesën edhe në gjuhën turke, në gjuhën angleze, rrome apo në ndonjë gjuhë tjetër dhe institucioni do të përpiqet të ofrojë shërbimet në gjuhën e parashtruesit.

